

- 2 Manifesti i Gastronomisë: 10 000 nënshkrime për kushte më të mira pune**
- 3 Dosja e Komisionit të Migracionit të BSZ-së Pjesëmarrje në vend të prekarizimit!**
- 4 Seminari i Unia shqip Së bashku për barazi e gjithëpërfshirje**

Nr. 2 | Mars 2023 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

2024: do hyjë në fuqi ligji i ri i AHV/AVS

Pasoja për pensionet Tuaja



Pamje nga aksioni i sindikatës Unia përkitazi me lansimit të nismës për një pension të 13 të AHV/AVS-së

Ligji i ri i AHV/AVS do të hyjë në fuqi në vitin 2024. Barazimi i moshës së pensionit për gratë dhe burrat i vendosur nga elektorati do të thotë që gratë do të duhet të punojnë më gjatë. Ligji i Arkave të Pensioneve Profesionale (BVG/LPP) po diskutohet gjithashtu në Parlament. Është planifikuar reduktim i mëtejshëm. Andaj, nisma e sindikatave për një pension të 13-të AHV që synon kompensimin e humbjeve në pension po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme.

Martin Jakob, workzeitung, 20 janar 2023 (e adaptuar)

Me një shumicë jashtëzakonisht të ngushtë dhe kundër një shumice të qartë të grave, reforma AHV u miratua më 25 shtator 2022. Këshillimi për urdhëresën nuk do të përfundojë deri në pranverë. Por në thelb qysh tash mund të thuhet se çfarë do të sjellë për secilin ndryshimi i ligjit. Këto janë risitë më të rëndësishme:

Gratë, të lindura më 1960, moshë e daljes në pension: Moshë e daljes në pension për ju është 64. Nëse dëshironi të punoni përtej kësaj moshë, mund të përfitonit nga mundësitë më fleksibël të pensionit nga 1 janari 2024 (shih më poshtë).

Gratë, të lindura midis 1961 dhe 1964, shtesa: Moshë e daljes në pension do të rritet hap pas hapi për ju dhe do të paguhet një shtesë pensioni për gjithë jetën. Shuma e saj varet nga të ardhurat mesatare që keni fituar në jetën tuaj të punës (shih tabelën). Shtesa nuk rezulton në ulje të asnjë përfitimi suplementar dhe paguhet edhe përmby pensionin maksimal.

Viti lindjes	Moshë e pensionimit	Shtesa në CHF */**		
		I	II	III
1961	64¼	40.-	25.-	12.50
1962	64½	80.-	50.-	25.-
1963	64¾	120.-	75.-	37.50
1964	65	160.-	100.-	50.-

* Shtesa mujore për një të ardhur mesatare prej I = maksimumi 58 800 CHF, II = 58 800 deri në 73 500 CHF, III = mbi 73 500 CHF.

Gratë, të lindura ndërmjet viteve 1965 dhe 1969, shtesa: Moshë e daljes në pension është 65 vjeç dhe paguhet një shtesë mbi pensionin për gjithë jetën.

Viti lindjes	Moshë e pensionimit	Shtesa në CHF */**		
		I	II	III
1965	65	160.-	100.-	50.-
1966	65	130.-	81.-	41.-
1967	65	101.-	63.-	32.-
1968	65	70.-	44.-	22.-
1969	65	40.-	25.-	13.-

* Shtesa mujore (shumat e rrumbullakosura në franga të plotë) me të ardhura mesatare prej I = maksimumi 58 800 CHF, II = 58 800 deri në 73 500 CHF, III = mbi 73 500 CHF.

Gratë e lindura midis 1961 dhe 1969, tërheqje e mëhershme: Gratë e lindura në këtë grupmoshë mund të marrin pensionin e tyre deri në tre vjet më herët nga 1 janari 2024. Megjithatë, duke e bërë këtë, ato heqin dorë nga shtesa për pensionimin e rregullt!

Gratë dhe burrat e lindur në 1961 dhe më të rinjtë, pagesa fleksibël e pensioneve: Gratë dhe burrat mund të marrin pensione të pleqërisë nga moshë mes 63 deri në 70 vjeç. Tani është e mundur që fillimisht të zgjidhet vetëm një pension i pjesshëm prej 20 deri në 80 për qind dhe më pas me një ose dy hapa të rritet në maksimum. Fillimi i pensionit mund të caktohet saktësisht në muaj – më herët, tërheqja e parakohshme ishte e mundur vetëm për një ose dy vjet të tërë. Pensionet e plotë apo pensionet e pjesshme të tërhequra para kohe çojnë edhe më tej në ulje dhe pensione të shtyra në shtesa, llogaritja kryhet pikërisht për muajin referues.

Me të ardhura të ulëta, pensioni i parakohshëm ulet më pak.

Arka e pensionit: aktet e pazgjidhura BVG/LPP

Nga ndryshimet e pritura me 2024 në AHV preken gjithashtu edhe arkat pensionale profesionale. Moshë e daljes në pension për gratë rritet paralelisht me AHV-në dhe arkat pensionale profesionale duhet t'u lejojnë të gjithë të siguruarve të tërheqin para kohe të gjithë ose një pjesë të pensionit ose ta shtyjnë atë ndërmjet moshës 63 dhe 70 vjeç. Megjithatë, nga moshë 65 vjeç, nuk janë më të siguruar përfitimet e rrezikut dhe vdekjes dhe fondi i pensioneve mund të përcaktojë në rregulloret e tij nëse kontributet për rritjen e kapitalit të pensionit janë ende të mundshme. Ligjërisht nuk është e detyrueshme.

Reduktimi i planifikuar

Megjithatë, këto përshtatje në asnjë mënyrë nuk do të zgjidhin mangësitë serioze në BVG/LPP. Sigurimi pensional profesional për punëtorët me të ardhura të ulëta dhe punëtorët me kohë të pjesshme po bëhet gjithnjë e më i shtrenjtë. Jo vetëm për gratë, të cilat janë të mbipërfaqësuar në këtë kategori, por për të gjithë punëtorët me status të kushte të pasigurta. Ato/a do të duhej të paguanin dukshëm më shumë në shtyllën e dytë të pensioneve, ndërkohë që pensionet e tyre vështirë se do të përmirësohen. Unia do të luftojë me referendum një ulje të pensioneve siç propozohet nga Senati. Gjithashtu, Unia angazhohet për forcimin e shtyllës së parë me një pension mujor të 13-të AHV/AVS. Për këtë nismë do të ketë votime në vitin 2023. (jk)

Editorial



Fuqia e gjithëpërfshirjes dhe pjesëmarrjes

Së fundmi, në seminarin e aktivistëve sindikalistë të Unia, diskutuam ndër të tjera edhe për grevën e grave dhe nismën e demokracisë të Aksionit «Vierviertel». Diskutimet e angazhuara dhe kontroverze me pro dhe kundër treguan mendimet e shumëllojshme në sindikatat tona dhe ishin një dëshmi e fuqisë së përfshirjes dhe pjesëmarrjes së barabartë e të 22 pjesëmarrësve.

Kishim të bënim me një laborator të tërë me idetë, perceptimet dhe botëkuptimet që u shkëmbyen dhe u prezantuan me respektin më të madh për mendimet e të tjerëve.

Pavarësisht këndvështrimeve të ndryshme, të cilat janë të rëndësishme në një diskutim demokratik, të gjithë ranë dakord në parim: luftërat sindikaliste janë solidaritet dhe luftë kolektive për barazi, pjesëmarrje dhe mënjanimin e të gjitha formave të diskriminimit, përjashtimit e ndarjes së punëtorëve. Një koleg punëtor ndërtimearie kishte mendim të qartë sa i përket pjesëmarrjes në grevën e grave, sepse kishte përjetuar solidaritetin e grave në luftën për një KKP më të mirë në ndërtime. Dhe me këtë rast fjala është edhe për të drejtat e motrave, nënave, vajzave, grave tona.

Një koleg i ri tha se edhe ne kemi nevojë për solidaritet mes nesh dhe në sindikatat tona duhet të luftojmë për më shumë pjesëmarrje dhe të drejta për çekun e popullsisë pa pasaportë zvicerane. Është një luftë kundër përkeqësimit të vazhdueshëm të lejeve të qëndrimit, kundër diskriminimit, një luftë e përbashkët për të forcuar të drejtat e kolegeve tona dhe në këtë mënyrë edhe të drejtat e të gjithë punëtorëve. Luftërat solidarizuese kanë nevojë për të gjithë ne!

Hilmi Gashi

News

Konferenca e Komisionit Federal për Migracion (EKM)

Konferenca Vjetore e EKM 2023 do të zhvillohet të enjten, më 6 prill 2023 me temë «Siguria Sociale në Shoqërinë e Migracionit Zvicër» në Casino Bern. Folësit nga hulumtimi, praktika dhe politika do të merren me çështje të ndryshme në lidhje me sigurinë sociale në shoqërinë e migracionit të Zvicrës dhe do të formulojnë zgjidhje të mundshme.

Regjistrimi është i hapur nga tani deri më 19 mars 2023. Pjesëmarrja është e mundur edhe drejtpërdrejtë në vend ose online: app.zoon.ch/event/ekm-jahreskonferenz-2023/register?step=1

Industria e punëve përmbyllëse në Zvicrën Perëndimore

Kërkesat u përcaktuan nga punonjësit në sondazhin e madh të kryer nga Unia nëpër kantiere. Këto përmirësime janë të nevojshme për të ardhmen e industrisë.

KKP-ja po ri negociohet, ja 5 kërkesat kryesore për një të ardhme më të mirë: 1. Më shumë pagë; 2. Rritja e kompensimit të ushqimit; 3. Koha e udhëtimit plotësisht e paguar; 4. Pushime të paguara për të gjithë; 5. Kantiere të pastra ndërtimi.

Me nënshkrimin tuaj ju mbështesni pesë kërkesat më të rëndësishme: unia.ch/de/kampagnen/gav-ausbaugewerbe-west-schweiz

Anketa e grave në ndërtimtarit

Gratë në ndërtimtarit kontribuojnë shumë! Megjithatë, gratë në ndërtimtarit janë në pakicë; Profesionet e ndërtimit konsiderohen një sferë mashkullore. Si rezultat, planifikimi i punës, proceset e punës, vetë puna apo infrastruktura janë përshtatur për nevojat e burrave.

Sindikata Unia dëshiron të zbulojë se si e ndieni veten në punën tuaj të përditshme dhe ku ju mendoni se përmirësimet janë të nevojshme në mënyrë që ju dhe kolegët tuaja të mund të qëndroni në profesionin tuaj. Bazuar në reagimet tuaja, ne bëjmë kërkesa në kontekstin e grevës së grave 2023. Këto kërkesa janë një bazë për negociimin e Kontratave Kolektive të Punës midis Unia dhe punëdhënësve. Nga përmirësimet e arritura përfitojnë të gjithë: ju, kolegët tuaja dhe kolegët tuaj. Ju lutem merrni 10 minuta kohë për anketën. Nuk është nevojta t'u përgjigjesh të gjitha pyetjeve: findmind.ch/c/kkai-PnDP

Negociatat për pagat: Punonjësit e Mondelez kërkojnë 6 për qind më shumë

Në fabrikën Toblerone në Bern-Brünnen, e cila i përket Grupit Mondelez, pritet të zhvillohen negociatat e pagave. Punëtorët po kërkojnë një rritje të përgjithshme të pagës prej 6 për qind. Kërkesa përfshin kompensimin e inflacionit dhe rritjen e primeve të sigurimeve shëndetësore si dhe një rritje në pagat reale. 6 për qind në përgjithësi – kjo është ajo që kërkojnë punëtorët e fabrikës Toblerone të Mondelez në negociatat e pagave të këtij viti. Me këtë rritje pagash, inflacioni prej 2,8 për qind dhe rritja e primeve të sigurimeve shëndetësore mund të kompensohen. Përveç kësaj, pas viteve të munguara, më në fund nevojitet një rritje e përgjithshme e pagave reale. Punonjësit meritojnë një pjesë nga fitimet rekorde të kompanisë.



Gastronomi: 10 000 nënshkrime për kushte më të mira pune

Punonjësit duan bisedime për një Kontratë Kombëtare Pune më të mirë

Punonjësit e Gastronomisë kërkojnë paga më të mira, marrja parasysh e përvojës profesionale tek pagat, planifikim më të hershëm të punës dhe më shumë kontrolle të kushteve të punës: Kërkesat e tyre i kanë formuluar në manifestin «Ne duam të jetojmë me dinjitet». Mbi 10 000 njerëz kanë mbështetur manifestin me nënshkrimet e tyre.

Hilmi Gashi

Rreth 50 persona të konferencës së sektorit të Gastronomisë në Unia i kanë dorëzuar shoqatës së punëdhënësve Gastrouisse manifestin «Ne duam të jetojmë me dinjitet» (shih vegën e mëposhtme). Ata kërkojnë rifillimin e bisedimeve mbi një Kontratë Kombëtare të re të Punës (KKP), pasi që bisedimet ka gati 4 vite që janë bllokuar. Mungesa e personelit në degën e Gastronomisë, pagat tejet të ulëta dhe kushtet e munguara të punës tregojnë: Nevojiten përmirësime të qarta.

Kërkesa konkrete për ta bërë punën më të përballueshme

Lista e përmirësimeve të nevojshme është gjithëpërfshirëse, mirëpo korrekte. Për ta bërë punën më të përballueshme si dhe degën më atraktive për punëmarrësit, duhet të përmirësohen dhe të rriten pagat minimale, zhveshja dhe orët e planifikuara, gjithashtu duhet të merret parasysh e të paguhet edhe përvoja profesionale. Më tej duhet një ndarje e drejtë dhe transparente e bakshisheve, planifikim të mirë të punës së paku paraprakisht 3 javë me shkrim si dhe dhënia fund punës me thirrje. Punonjësit e gastronomisë



Punonjësit e Gastronomisë të mbështetur nga sindikata Unia kërkojnë jetë me dinjitet



Manifesti i Gastronomisë kërkon një KKP vendore më të mirë.

duan, që ndërmarrjet të investojnë në arsimim të personelit përgjegjës dhe të ndërmarrin masa kundër të gjitha formave të ngacmimit. Duhet më shumë kontrolle, për të mundur respektimin e kushteve të punës.

Të gjithë në grevën e grave

Delegatët e gastronomisë garantuan gjithashtu mbështetjen e tyre për grevën e grave të 14 qershorit 2023. Greva e grave është një mundësi tjetër për të adresuar pagat e grave, kuotat e larta të punës me kohë të pjesshme, mungesa e pajtueshmërisë së punës dhe jetës private si dhe ngacmimi në rritje kundër grave në vendin e punës. Nga të gjitha këto probleme është prekur fuqishëm zeja e gastronomisë.

Manifesti i Gastronomisë

DE <https://bit.ly/3ye6SQL>
FR <https://bit.ly/3mrJ5u8>
IT <https://bit.ly/3ZD0wnW>
PT <https://bit.ly/3SQcIBs>

Kërkesat për paga në COOP

Kërkesat e punonjësve «Më shumë respekt për punën tonë»

Nën moton «Më shumë respekt për punën tonë», më shumë se 100 anëtarë të Unia nga Coop u mblodhën për konferencën e tyre të grupit profesional në Basel. Shumë me shumë se ndonjëherë më parë. Ata diskutuan kërkesat e tyre me Luc Pillard, kreu i Resurseve Humane (HR) në Coop dhe e bënë të qartë se duhet të ketë më shumë në raundin tjetër të negociimit të pagës

Emine Sariasslan

Më shumë se 100 anëtarë të Unia tek Coop po tregojnë: Pakënaqësia me përfundimin e negociatave të pagave po mobilizon shumë punonjës. Ata nuk e kuptojnë pse fitimi i madh që ata gjenerojnë me punën e tyre gjithnjë e më fleksibel dhe intensive nuk po ndahet edhe me ta. Punonjësit e Coop nuk morën as kompensimin e plotë të inflacionit. Prandaj anëtarët e Unia që punojnë në Coop kërkojnë për të ardhmen:

- Kompensim të plotë inflacioni
- Vlerësim i qëndrueshëm i të gjitha pagave
- Më shumë respekt për punën e tyre
- Më pak presion dhe fleksibilitet

Zë i përbashkët për paga korrekte

Me Unia, punonjësit e Coop mund të bëjnë që pakënaqësia e tyre të dëgjohet: Shefi i HR Luc Pillard mori pjesë në një diskutim që zgjati më shumë se një orë në të cilin anëtarët e Unia në Coop shpjeguan se si duket puna e tyre e përditshme dhe ku ata do të donin të shihnin përmirësime.

Pikërisht në vitin e grevës së grave 2023, delegatët e Unia nuk mund të pranojnë më që në veçanti gratë do të vazhdojnë të

jenë të pafavorizuara nga ana strukturore. Duhet të ketë një ndryshim kursit në degë në mënyrë që nevojat e tyre të merren parasysh më mirë dhe puna e tyre të marrë më shumë njohje.

Kjo është e vetmja mënyrë për ta mbajtur tërheqëse punën në Coop dhe në të gjithë sektorit për brezin e ri. Coop në këtë pikë ka një funksion model dhe këtu delegatët Unia shpeshojnë se kompania gjithashtu do të perceptojë një rol të tillë!

Është koha e fundit për të vu binarët e drejtë që tregtia me pakicë të largohet nga sektori me paga të ulëta!

Sindikata Unia është partneri më i fortë kontraktual në Kontratave Kolektive të Punës (KKP) për Coop. Unia dhe anëtarët e saj aktivë në Coop janë të angazhuar në përmirësimin e kushteve të punës. Unia mbështet anëtarët e saj në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punësimit dhe i mbështet ata në zbatimin e të drejtave të tyre.



Punonjësit e Coop të organizuar në sindikatën Unia kërkojnë më shumë respekt për punën e tyre.

Nisma parlamentare «Varfëria nuk është krim»

Tani të mblidhen me urgjencë nënshkrimet

Nëse migrantët kanë nevojë për ndihmë sociale pas një aksidenti, sëmundjeje ose situatë në nevojë, e drejta e tyre e qëndrimit është në rrezik. Edhe pse kushtetuta zvicerane garanton mbështetjen e të gjithë njerëzve në vend në një situatë emergjente, kjo nuk vlen për njerëzit pa pasaportë zvicerane – kjo është ajo që kërkon Ligji për të huajt dhe për Integrim (AIG/LEI). Me qëllim që ta ndryshojë këtë, deputetja nacionale Samira Marti ka paraqitur nismën parlamentare «Varfëria nuk është krim». Parlamenti nacional e pranoi nismën, por Senati e hodhi poshtë atë. Çfarë do të ndodhë më tej?

Maria Mendes

Ana është portugeze dhe jeton në Zvicër për gati 15 vjet. Ajo ka punuar shumë, por me sëmundjen e saj të pashërueshme nuk mund ta bëjë më këtë. Sigurimi i invaliditetit (IV/AI) e shih këtë ndryshe dhe ia mohon Anës një pension të invaliditetit. Pa të ardhura, e vetmja mundësi e Anës është të drejtohet tek asistencë sociale. Pasoja: leja e saj e qëndrimit nuk do të zgjatet. Ajo nuk e di se çfarë të bëjë tjetër: si do të kthehet në Portugal, pa punë, pa para, pa askënd që mund ta mbështesë atje?

Forcë punëtore por pa situatë në nevojë

Shumë migrante e migrantë në Zvicër ndihen njësoj si Ana. Ata janë të nevojshëm si punëtorë, por në qoftë se ata gjenden në një situatë nevojë, ata nuk janë më të dëshiruar këtu dhe duhet të largohen nga vendi. Që kur AIG/LEI hyri në fuqi në vitin 2019, marrja e ndihmës sociale mund të çojë në humbjen e lejes së qëndrimit. Kjo vlen për të gjithë migrantët, madje edhe për ata që kanë lindur dhe janë rritur këtu.



Këtë situatë iniciativa parlamentare «Varfëria nuk është krim» dëshiron të ndryshojë: Në rastin e migrantëve që kanë jetuar në Zvicër për më shumë se dhjetë vjet, nuk duhet të jetë më e mundur tu hiqet leja e tyre nëse ata pa fajin e tyre kanë marrë ndihmë sociale.

Nënshkruaje dhe shpërndaje letrën e hapur

Në sesionin e verës, nisma do të shkojë në Senat. Kjo është arsyeja pse nisma ka nevojë edhe për mbështetjen tuaj: Mblidhni nënshkrimet nëpërmjet mediave tuaja sociale. Shpërndaje vegën me letrën e hapur për parlamentarët. Petitioni – Varfëria nuk është krim! (poverty-is-not-a-crime.ch/de)

Dosja e Komisionit të Migracionit të BSZ

Ndal prekarizimit, Pjesëmarrje tani!

Dosja «Pjesëmarrja në vend prekariteti» doli nga Konferenca e Migracionit të Bashkimit të Sindikatave të Zvicrës (BSZ) e 4 shtatorit 2021. Me këtë rast, më shumë se 70 sindikalistë me sfond migracioni analizuan rreziqet specifike për punëtorët pa pasaportë zvicerane dhe diskutuan strategjitë e politikave të sindikatave se si mund të arrihet siguria sociale dhe pjesëmarrja politike për ta.

Hilmi Gashi, Johannes Gruber dhe Regula Bühlmann

Dosja «Pjesëmarrja në vend prekariteti» doli nga Konferenca e Migracionit të Bashkimit të Sindikatave të Zvicrës (BSZ) e 4 shtatorit 2021. Me këtë rast, më shumë se 70 sindikalistë me sfond migracioni analizuan rreziqet specifike për punëtorët pa pasaportë zvicerane dhe diskutuan strategjitë e politikave të sindikatave se si mund të arrihet siguria sociale dhe pjesëmarrja politike për ta.

Struktura e dosjes ndjek përballen e prekaritetit dhe pjesëmarrjes. Pjesa e parë ka të bëjë me situatat e pasigurta të jetës që fillojnë me braktisjen e vendit të origjinës. Kontributet e mbledhura tregojnë se kjo pasiguri nuk përfundon me kalimin e kufijve. Shumë migrantë vazhdojnë të jetojnë në mënyrë të pasigurt edhe në Zvicër. Kjo në një kuptim të dyfishtë. Në tregun e punës, ata janë dukshëm më të punësuar në sektorët me paga të ulëta se sa popullsia vendase, kryejnë punë të përkohshme ose punojnë me thirrje. Për migrantët, megjithatë, një pasiguri e tillë nuk është thjesht një sfidë e përkohshme që duhet të arrihet me shkathtësi dhe zotësi. Dosja tregon se përqendrimi i Ligjit për të huajt dhe integrim (AIG/LEI) në vitet e fundit ka bërë që varfëria tanimë të bëhet një kërcënim ekzistencial për migrantët: në rastin e varësisë nga ndihma sociale, ata rrezikojnë të humbasin të drejtën e tyre të qëndrimit dhe të përjashtohen nga Zvicra.

Perspektivat e pjesëmarrjes në demokraci dhe shoqëri

Pjesa e dytë e dosjes zhvillon perspektiva për pjesëmarrjen. Si një grup mbrojtës për të gjithë punëtorët, sindikatat janë gjithashtu të angazhuara për të drejtat e migrantëve. Anëtarësimi në një sindikatë nuk lidhet me një shtetësi specifike. Si kolegë, ne kemi prejardhje të ndryshme, por interesa dhe përpjekje të përbashkëta. Paga dhe dumpingu social vënë në pikëpyetje gjithashtu pagat dhe kushtet



e punës të grupeve që nuk janë (ende) të prekura drejtpërdrejt. Prandaj përmes artikujve në dosje edhe krijohet bindja se përpunimi shoqëror mund të arrihet vetëm së bashku. Dhe kjo përfshin edhe pjesëmarrjen politike të të gjithë njerëzve në Zvicër. Çfarë lloj demokracie do të ishte kjo, në të cilën një pjesë e madhe e popullsisë përjashtohet përgjithmonë nga mirëqenia dhe bashkëvendosja? Dosja është e lidhur ngushtë me punën e Komisionit të Migracionit të BSZ. Ajo tregon se sa të rëndësishme janë nismat politike të tilla si «Varfëria nuk është krim!» dhe Aksioni «Vierviertel». Dhe kontribuon në debatet dhe nismat e ardhshme në Kongresin BSZ në vitin 2022 dhe më tej. Si një lëvizje e sindikatave, ne luftojmë për sigurinë sociale dhe pjesëmarrjen politike të të gjithë njerëzve në këtë vend deri sa të arrijmë këtë qëllim.

Intervista



Dhuna në familje: Dhuna është e palejueshme!

Përparësi të drejtës së viktimës para të drejtës së qëndrimit!

Aktualisht, fakti që viktimat e dhunës në familje janë të varura nga autorët e tyre për sa i përket ligjit të vendbanimit, do të thotë se të prekurat janë kryesisht të izoluar dhe vazhdojnë të vuajnë nga marrëdhëniet e dhunshme. Kjo duhet të ndryshojë urgjentisht. Një konsultim federal «Garancia e praktikës për arsye të rëndësishme personale në përputhje me nenin 50 AIG në rastin e dhunës në familje» ka mobilizuar në masë të madhe rrjetet e solidaritetit, përfshirë Bashkimin e Sindikatave të Zvicrës (BSZ). Aude Spang, Sekretare e Mundësive të Barabarta në sekretariat qendror të Unia-s, është një nga bashkë-presidentet e Komisionit Feminist të BSZ-së.

Aude, deri në cilën masë nuk mbron ligji të gjitha viktimat e dhunës në familje?

Në lëmin e dhunës kundër grave Zvicra ka ratifikuar Marrëveshjen e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, të ashtuquajturën Konventë të Stambollit. Mirëpo këtë e ka bërë me rezervë. Nëse në të vërtetë viktimat, leja e qëndrimit e së cilës varet ajo e bashkëshortit të saj, shkak i dhunës ndahet nga bashkëshorti, atëherë viktimat rrezikojnë të humbë të humbë lejen e qëndrimit. Kjo prek personat nga të ashtuquajturat «shtete të treta», pra pa pasaportë të BE/EFTA. Çuditërisht, shumica dërrmuese janë gra që keqtrajtohen nga burrat e tyre – pavarësisht nëse janë zviceranë apo jo.

Cilat janë pasojat konkrete të rrezikut, për të humbur lejen e qëndrimit?

Aktualisht, ligjet dhe zbatimi i tyre shumë shpesh favorizojnë ruajtjen e marrëdhënies të dhunshme në çift sesa mbrojtjen e viktimave. Kërkimi i ndihmës kur ekziston rreziku për tu dhunuar në çdo situatë është një hap jashtëzakonisht i vështirë dhe i dhimbshëm për t'u ndërmarrë. Nëse dikush mëson se është kërcënuar edhe me dëbim, nuk është vetëm viktimë e dhunës së një personi, por edhe viktimë e dhunës së Zvicrës. Kjo është e papranueshme, ne refuzojmë që të mbyllem sytë. Varësia nga një «kryefamiljar» është një motiv i tejkaluar që nuk mund të përdoret më për të legjitimuar pabarazitë skandaloze ligjore.

BSZ-ja, disa organizata dhe shoqata femine për mbështetjen dhe këshillimin e viktimave, si dhe rrjetet e solidaritetit kanë mund të komentojnë mbi një konsultim federal deri më 15 mars. Çfarë po kërkojnë?

Kryesisht kërkojmë shtrirjen e të drejtës për t'u dhënë dhe zgjedhur qëndrimin në Zvicër në rastet e dhunës në familje për të gjithë personat, pavarësisht nga leja e tyre e qëndrimit. Gjithashtu edhe reduktimin e kërkesave për raportim dhe heqjen e mospërputhjeve në legjislativon për mbështetjen e viktimave, si dhe heqjen e nivelit minimal të «intensitetit» të dhunës (sikur dhuna e caktuar të ishte e pranueshme!). Gjithashtu bëjmë thirrje për përfshirjen e qartë të të gjithë personave që jetojnë në partneritet në rregulloren për çiftet që bashkëjetojnë, pavarësisht nga identiteti gjinor apo orientimi seksual. Kjo përfshin ratifikimin dhe zbatimin e Konventës 190 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës për Eliminimin e Dhunës dhe Ngacmimit në Botën e Punës, e cila daton nga viti 2019. Ne llogarisim që zëri ynë do të dëgjohet!

Marie Saulnier Bloch

Ju pyesni, Unia përgjigjet

WC në vendin e punës: A duhet të përdor tualetin publik?



GJËJA E QARTË: Në punë duhet të ketë një WC falas. Për këtë duhet të kujdeset shefi. (Foto: ZVG)

Unë jap katër herë në javë katër orë në kurs për enë qeramike. Duke përfshirë përgatitjen dhe kohën e mëpasshme të përpunimit, e cila përfshin edhe djegien e objekteve prej argjille, unë jam në punë gjithmonë për rreth 6 orë. Në ndërtesën ku unë ofroj kurset, duhet të rinovohen ndërtesat sanitare. Renovimi do të marrë rreth dy javë kohë. Tani na kanë njoftuar se gjatë kësaj kohe nuk mund të na jepej për shfrytëzim asnjë tualet. Duhet të përdorim tualetin publik në stacionin e trenit aty afër. Megjithatë, për të shkuar atje na duhen rreth 5 minuta çdo herë dhe as tualeti nuk është falas. Gratë atje paguajnë 2 franga. A lejohet që punëdhënësi ynë ta bëjë këtë?

Regula Dik: Jo, punëdhënësi yt është i detyruar të të sigurojë një tualet që mund ta përdorësh pa pagesë. Kjo është theksuar qartë nga ligjvënësi përmes një urdhërese në Ligjin e Punës (Art. 32 ArGV 3). Prandaj, ai duhet të kujdeset që të keni një tualet falas, të cilën mund ta arrini në një kohë të arsyeshme. Për shembull, duke siguruar një tualet të lëvizshëm (mobil) ose në varësi të situatës, duke të lejuar t'i përdorni tualetet të një ndërtesë në afërsi. (Work, 17.2.23)

Shtatzënia: A mund të largoi nga puna shefi për shkak të kësaj?

Kam pesë muaj që punoj me një punë 40 për qind si shitëse në një dyqan me pakicë. Kohët e fundit, mjeku im konfirmoi se ka dy muaj që jam shtatzënë. Unë do të kem fëmijën tim të dytë dhe jam shumë e lumtur! Shefi im, megjithatë, ishte më pak i kënaqur me këtë lajm. Ai më tha se isha ende në punë provuese dhe se do t'i duhej të më largojë nga puna. Ai thotë se nuk mund të lejoni mungesat në punë për shkak të shtatzënisë. Dhe ngaqë punoj vetëm 40 për qind, periudha ime e punës provuese është më e gjatë se zakonisht, domethënë 7.5 në vend të 3 muajve. A është e vërtetë kjo?

Regula Dik: Jo, në rastin e punësimit me kohë të pjesshme, kohëzgjatja e periudhës e punës provuese nuk zgjatet. Meqenëse keni rënë dakord me kontratë tre muajshe, periudha e punës provuese përfundon pas tre muajsh. Jashtë periudhës së punës provuese, nuk mund të pushohesh nga puna për gjithë kohëzgjatjen e shtatzënisë dhe deri në 16 javë pas lindjes së fëmijës. Nëse do të ishe ende në periudhën e punës provuese, largimi nga puna për shkak të shtatzënisë do të ishte e vlefshme, mirëpo abuzuese. Ligji mbi Barazinë Gjinore (GIG/LEg) ndalon diskriminimin ndaj një personi në bazë të gjinisë së tij ose të saj. Ky do të ishte qartësisht rasti i largimit për shkak të shtatzënisë. Shefi juaj do të shkelte ligjin, dhe ju do të keni të drejtë për kompensim sipas ligjit. (Work, 17.2.23)

Papunësia: Harrimi i formularit – a do të marr ende mëditje?

Mjerisht, unë nuk e kam dorëzuar formularin tim «Të dhënat e personit të siguruar» (AVP) për muajin shtator 2022 deri në janar 2023 në Arkën e sigurimit të papunësisë. Tani Arka në fjalë nuk do të më paguajë asnjë përfitim për muajin në fjalë. A mundet Arka ta bëjë këtë?

Nikol Debrunner: Po. Arka i sigurimit të papunësisë mund të paguajë përfitimin mujor të papunësisë posa ta marrë formularin me të dhënat e kërkimit të punës. Arka ka nevojë për këtë në mënyrë që të përcaktojë të drejtën tuaj specifike për muajin në fjalë. E drejta për kompensim për muajin në fjalë skadon nëse nuk bëhet e vlefshme brenda 3 muajve nga fundi i muajit me të cilin lidhet. Prandaj do t'ju duhej ta dërgonit formularin më së largu deri në fund të dhjetorit në mënyrë që të mund të pretendoni ende përfitimet e shtatorit. Tek afati i thënë kemi të bëjmë me një periudhë konfiskuese. Kjo do të thotë se një pretendim është plotësisht i pavlefshëm nëse nuk është bërë i vlefshëm me kohë. E rëndësishme për t'u ditur: kërkesa për përfitim nga papunësia është thjesht një e drejtë, jo një detyrim. Nuk kemi të bëjmë gjithashtu me të drejtën themelore për kompensim, por kërkesa rishqyrtohet dhe miratohet për çdo muaj në bazë të dokumenteve të paraqitura. (Work, 3.3.23)

Dita ndërkombëtare e gruas: 8 Marsi»

Përpara në vend se prapa! Barazi tani!

8 marsi është dita ndërkombëtare e të drejtave të grave. Është fillimi i parë i madh për grevën e grave në 2023'tën. Ne fillimisht dalim në rrugë dhe kërkojmë që barazia përfundimisht të zgjidhet.

Darinka Filipovic

Gratë janë të disfavourizuar - vetëm sepse janë gra: Diskriminimi në paga ndodh ende në masë të madhe, përputhshmëria e punës dhe jetës private është një rrugëtim me hendeqe dhe diskriminimi ndaj grave vazhdon edhe në pleqëri: Pensionet e ulëta që vështirë se mjaftojnë për të jetuar janë pjesë e përditshme e problemit për shumë gra. Pagat në vend në vend të rritjes po shkojnë prapa. Edhe pensionet në vend se përpara po shkojnë prapa. Prapa në vend se përpara edhe tek ndarja e punëve të përkujdesjes. Është koha e fundit që kjo të ndryshojë.

Të veprojmë aktivisht! Në rrugë dhe nëpër ndërmarrje.



Greva e grave 2023 - Respekt, më shumë pagë, më shumë kohë

Përgatitjet për grevën e grave në 2023 dhe puna e sindikatave për zgjerim në sektorë dhe ndërmarrje të ndryshme nëpër regjione janë në lëvizje të plotë.

Sot, me 8 Mars – 99 ditë para grevës së re të grave më 14 qershor, nis numërimi mbrapsht i Unia. Jemi duke u mobilizuar për ditën e madhe me një sërë videosh në YouTube dhe rrjete sociale. Sepse barazia duhet të shkojë përpara – dhe jo më mbrapa! Kjo është edhe motoja jonë në Ditën Ndërkombëtare të Gruas më 8 Mars.

Këtë vit, Unia është duke shkuar nëpër ndërmarrje për të mbështet gratë në realizimin e takimeve dhe fushatave. Gjithçka me qëllimin e qartë: të ngremë zërin lartë e qartë se po luftojmë trajtimin e pabarabartë.

Manifestimet e 8 marsit me moton Bashkërisht për kushte më të mira pune në Bazel, Bernë, La Chaux de Fond, Delémont, Friburg, Gjenevë, Lozanë, Luzern, Neuchâtel, Solothurn, St. Gallen, Winterthur, Cyrih – një lëvizje e mirë për gratë 2023 grevë .

Seminari në gjuhën shqipe për aktivist sindikal të Unia

Së bashku për arritjen e barazisë, mirëqenies dhe gjithëpërfshirjes

Në këtë seminar, ku morën pjesë mbi 20 aktiviste e aktivistë shqiptarë të sindikatës Unia, u trajtuan temat sindikaliste dhe ato që kanë të bëjnë me shoqërinë migrante si dhe komunitetin shqiptar në Zvicër. Krahas udhëheqësit të seminarit, Hilmi Gashi, në këtë seminar kontribuuan edhe dy bashkëdrejtues të Organizatës GERMIN, Sihana Bejtullahu e Lirim Krasniqi si dhe këshilltarja juridike e sindikatës Unia për regjionin e Gjenevës, Linda Redzaj-Maliqi dhe kryetari i platformës prointegra.ch, Osman Osmani.

Osman Osmani

Me 11 e 12 mars 2023 në Flora Alpina të Vitznau / LU u mbajt seminari në gjuhën shqipe për aktivistet e aktivistët e sindikatës Unia, i organizuar dhe drejtuar nga Hilmi Gashi, drejtues i grupeve të interesit në sindikatën Unia.

Temat kryesore e seminarit dy ditor ishin:

1. **Nisma popullore për natyralizim e shoqatës Aktion Viertel:** Përmbytja, qëllimet, mundësitë e veprimt. Roli i aktivistëve/aktivisteve gjatë mbledhjes së nënshkrimeve dhe në fushatë. Në grupet punuese un skicuan idetë konkrete për hapat vijues, si informimi dhe mobilizimi në shoqatat e migrantëve, biseda në familje, me kolege dhe kolegë të punës,
2. **14 qershori 2023:** Greva e grave nëpër degë të ekonomisë private dhe roli dhe kontributi i aktivistëve / aktivisteve përgjatë mobilizimit për grevën. Edhe në këtë pikë bashkëbisedimi ishte i gjallë. U vendos që përveç pjesëmarrjes aktive të ketë shkëmbime më të shpeshta me grupet e grave në vendet amë, të cilat punojnë në barazinë gjinore. Konkretisht të bëhet një diskutim në takimin e ardhshëm të diasporës në Prishtinë të organizuar nga Germin.
3. **Roli i mërgatës në fuqizimin e dialogut mes Zvicrës dhe vendeve amë,** sidomos kur ndër të tjera bëhet fjalë edhe për të drejtat e tyre dhe për fuqizimin e sindikatave në Kosovë.



«Anëtarët bëjnë anëtarë» – me shembuj konkret dhe argumente të bazuara në sukseset dhe të arriturat sindikale të angazhohemi më shumë në rekrutimin dhe përfitimin e anëtarëve të rinj për lëvizjen sindikale

Në përgjithësi në këtë Seminar 2 ditorë pas referateve e prezantime hyrëse u zhvilluan diskutime e bashkëbisedime dhe u punua edhe në grupe punuese, ku u shkëmbyen e dhanë ide dhe propozime konkrete e të vlefshme për angazhim në drejtim të realizimit të qëllimeve sindikaliste dhe synimeve për fuqizim e të drejtave edhe politike të migrantëve dhe pjesëtarëve të komunitetit tonë.

Seminari në gjuhën shqipe për aktivistet e aktivistët e sindikatës Unia zakonisht mbahet çdo vit. Shkaku i pandemisë, ai nuk është zhvilluar në dy-tri vitet e fundit.



Vlerësim i meritueshëm që nderon edhe angazhimin e sindikalistëve shqiptar në Zvicër: Në fund të seminarit, kryetar i aktivistëve të regjionit Cyrih-Shafhauzen, Xhafer Sejdiu në emër të aktivistëve sindikalist shqiptarë të sindikatës Unia të Zvicrës, i dorëzoi drejtuesit të seminarit Hilmi Gashit portretin e tij, të punuar nga artisti me renome ndërkombëtare Gazmend Freitag, i cili jeton e vepron në Linz të Austrisë, e i cili portretizon personalitete të ndryshme ndër të tjera nga fusha e historisë, kulturës, artit, filantropisë, politikës dhe qytetarisë aktive. Ky vlerësim i artistit për kolegun e bashkëdrejtuesin tonë nga të pranishmit u prit me mirënjohje dhe u vlerësua si akt që nderon angazhimin e pjesëtarëve të komunitetit tonë në lëvizjen sindikaliste e sociale si dhe aktiv në fuqizimin e komunitetit si në raport me Zvicrën dhe vendet amë.